

RELACION

PËR

PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT

“PËR PRANIMIN E SKEDULIT CXLVI TË ZGJERIMIT TË LISTËS TË MARRËVESHJES SË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT NË KUADËR TË ORGANIZATËS BOTËRORE TË TREGTISË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Shqipëria është anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë nga shtatori i vitit 2000 dhe politika tregtare ndjek parimet dhe rregullat e kësaj organizate. Shqipëria ndjek të gjitha zhvillimet në OBT dhe përditëson në mënyrë periodike legjislacionin e saj në përputhje me rregullat e përcaktuara nga kjo organizatë.

E gjithë strategjia e politikës tregtare pas anëtarësimit në Organizatën Botërore të Tregtisë është mbështetur në Ligjin Nr.8648, datë 28.7.2000, “Për ratifikimin e protokollit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen e Marrakeshit, që themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë” dhe në (ii) Ligjin Nr. 8649, datë 28.07.2000, “Për ratifikimin e rezultateve të Raundit të Uruguait të negociatave tregtare shumëpalëshe”.

Një nga marrëveshjet e OBT-së, në të cilat Shqipëria është palë qysh nga çasti i anëtarësimit është edhe ajo e Teknologjisë së Informacionit (ITA), bazuar në ligjin Nr.8648, datë 28.7.2000, “Për ratifikimin e protokollit të anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Marrëveshjen e Marrakeshit, që themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë”. Skeduli i koncensioneve dhe angazhimeve në mallra përcaktohet në nenin 1 pika 2 e ligjit 8648, datë 28.7.2000. Sipas marrëveshjes ITA për produktet që përdoren në teknologjinë e informacionit vendet anëtare të kësaj marrëveshje nuk aplikojnë tarifa doganore në import.

Në kuadër të negociatave të axhendës së DOHA për Zhvillim, vendet e zhvilluara anëtare të OBT-së kanë propozuar rishikimin e listës së produkteve të Marrëveshjes së Teknologjisë së Informacionit me objektiv zgjerimin e saj. Kjo qasje e përdorur nga vendet e zhvilluara është e nxitur dhe kushtëzuar nga zhvillimet që ka teknologjia e informacionit, e cila ka patur avancime thelbësore në dekadën e fundit.

Ky proces ka filluar që në vitin 2012, kohë në të cilën me kërkesën nga Bashkimi Evropian, një ndër liderët e këtij procesi, Shqipëria iu bashkua iniciativës së BE (co-sponsor) si pjesë e detyrimeve të Shqipërisë për përafrimin e politikës tregtare me Politikën e Përbashkët Tregtare të BE, në zbatim të MSA.

Për t'iu bashkuar propozimit të BE, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (ish METE) ka zhvilluar konsultimet midis institucioneve shqiptare. Për këtë, Ministria e Financës dhe Ministria përgjegjëse për Inovacionin dhe Teknologjinë kanë dhënë dakortësinë e tyre për tu bërë pjesë e kësaj liste. Pas pranimit nga institucionet përgjegjëse është dhënë përgjigje pozitive kërkesës së Bashkimit Evropian nëpërmjet Misionit tonë në Gjenevë.

Shqipëria ka mbështetur listën e propozuar nga Bashkimi Evropian duke e zgjeruar atë edhe me produkte të tjera, të cilat do të ndikojnë në teknologjinë e informacionit. Në vijim, edhe me sygjerimin tonë, përfaqësues të Misionit në Gjenevë kanë ndjekur takimet dhe negociatat për t'iu përgjigjur kërkesave që duhet të plotësojë Shqipëria. Ndërkohë, ne jemi mbështetur me ekspertizë teknike nga Misioni i BE në Gjenevë për detajimin dhe skedulimin kohor të angazhimeve tona.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projekti është në linjë me fushën e veprimtarisë shtetërore që ka Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ndryshimi i këtij ligji vjen si pasojë e ndryshimeve dhe zhvillimeve të teknologjisë së informacionit vitet e fundit. Për këtë, vendet anëtarë të OBT kanë punuar për të reduktuar tarifën për produktet që prekin këtë fushë.

Një nga qëllimet kryesore të ndryshimit të këtij ligji janë eliminimi i tarifave për produktet e propozuara në këtë listë si dhe eliminimi i barrierave jo-tarifore që krijojnë pengesa tek produktet e teknologjisë së informacionit. Në mënyrë për të çuar më tej objektivin e tregtisë pa pengesa në produktet e teknologjisë së informacionit, zgjerimi i ITA përfshin një rezultat të matur, por kuptimplotë në eliminimin e tarifave përfitimet e të cilit do të jenë potencialisht të rëndësishme.

Relacion shpjegues “Për propozimin e projektligjit “Për pranimin e Skedulit CXLVI të zgjerimit të listës të Marrëveshjes së Teknologjisë së Informacionit në kuadër të Organizatës Botërore të Tregtisë””

Këto ndryshime do të sjellin reduktimin e kostos për të gjitha produktet nën mbulimin e ITA.

Praktika në OBT për vendet anëtare kërkon që secili vend, nëpërmjet parashikimeve të marrëveshjeve si dhe të Konventave të tjera Ndërkombëtare të “**pranojnë**” angazhimet që dakordësohen në strukturat përkatëse të OBT.

Kështu, miratimi i skedulit të produkteve ITA do të bëhet nëpërmjet instrumentit të “pranimit” , i cili është ndjekur edhe më parë me pranimin e Marrëveshjes të Lehtësimit të Tregtisë, miratuar me Ligjin nr.7/2016 datë 4.2.2016

Në përfundim të procesit, skeduli **CXLVI**, do të bëhet pjesë e skedulit të kondensioneve dhe angazhimeve në mallra të Shqipërisë në OBT.

VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Mbështetur në nenin 121 të Kushtetutës dhe nenit 18 të ligjit nr.43/2016 “ Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”.

IV. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projekt akt nuk synon përafrim me *Acquis Communautaire*

V. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Teksti i përcaktuar në Skedulit e aprovuar të listës përmban kodet tarifore të listuara sipas Sistemit të Harmonizuar 2007, përshkrimin e produkteve, tarifa bazë aktuale, reduktimi i tarifës dhe vitet për të cilat do të reduktohen tarifat.

VI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si institucioni përgjegjës për zbatimin e angazhimeve të ndërrmarra në kuadër të anëtarësimit në Organizatën Botërore të Tregtisë.

Ministria e Financës

PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projekt marrëveshja parashikon efekt financiar për vitin 2017 në vlerën (9, 202, 822) lekë dhe për vitin 2018 në vlerën (17,867,265).

**MINISTRI I ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE
SIPËRMARRJES**

MILVA EKONOMI